



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:259436

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05845605

KPPP.nr.1997/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbarimore të kreditorit NTP “Modeli” me numër unik identifikues 810671893 me seli në Viti, kundër debitorit F.R. “Stublla” O.P., me numër unik identifikues 81104124 me seli në fshatin Stubëll, Komuna e Vitisë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.667/23të datës 09.11.2023 të Përmbaruesit Privat Argjent Xheladini, me seli në Viti, jashtë seancës me datës 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit F.R. “Stublla” O.P., i ushtruar ndaj Urdhrit P.nr.667/23 të datës 09.11.2023 të Përmbaruesit Privat Argjent Xheladini.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr.667/23i datës 09.11.2023 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Argjent Xheladini, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “NTP “Modeli” ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.667/23 të datës 09.11.2023 me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr.000944 të datës 30.12.2022 në shumë prej 871.70€, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 871.70€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore. Të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të hapura në bankat komerciale dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare apo përmes

përmbartimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit dhe me shitjen të bëhet inkasimi i borxhit.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor me arsyetimin se fatura si dokument i besueshëm në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbartimore nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori. Tutje pretendon se fatura e paraqitur nuk përbën dokument të besueshëm, pasi që nuk përmban elementet e përmbartueshmërisë. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi prapësimin e debitorit si të bazuar si dhe ta anuloj urdhrin përmbartimor. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: "*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: "*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*".

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbartimor P.nr.667/23i datës 09.11.2023 bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht Faturës me nr.000944 të datës 30.12.2022 në shumë prej 871.70€, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata

gjen se faturat mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbartimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal.

Andaj, në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1997/23, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.